

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorit të kërkesës nr. 2 të KSHZ”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Znj. M. Çelmeta, Z. E. Mema.**

Znj. M. Çelmeta: Përshëndetje! Sot në datën 7.06.2024, do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit për kërkesën nr. 2, të Komisionerit Shtetror të Zgjedhjeve drejtuar KAS “Për vendosje sanksioni administrativ”. Procedura e hedhjes së shortit është e parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në njërin prej tyre është shënuar kërkesa nr. 2 e KSHZ dhe katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat do të futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njejtë nga një përfaqësues i administratës. Pesë shiritat e futur në gogla do të futen në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues nga KQZ-ja që do të tërheqë goglat, në emër dhe për llogari të tyre, për përcaktimin e relatorit. Pasi përzjejmë goglat, vazhdojmë me rendin alfabetik ngjitës, duke filluar nga:

Zoti Elvin Lako: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë me:

Zotin Elvis Çefa: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë me:

Zotin Ilirjan Rusmali: – Shiriti është me shënimin: kërkesa nr. 2 e KSHZ.

Vazhdojmë me:

Zotin Koli Bele: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 7.06.2024*

Vazhdojmë me:

Zotin Ledio Braho: – Shiriti është përsëri i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, relator i kërkesës nr. 2 është zoti Ilirjan Rusmali.

Seanca mbyllet, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

